

RREGULLORE E GARËS SË VRAPIMIT MALOR “PEJA TRAIL RUN”

Neni 1 – Organizatori

Gara organizohet nga **Klubi i vrapimit malor Peja Trail Run**, me seli në **Pejë**, në kuadër të aktiviteteve sportive dhe promovimit të vrapimit malor, jetës aktive dhe natyrës.

Neni 2 – Qëllimi i Garës

Qëllimi i garës është:

- promovimi i sportit të trail running;
- promovimi i jetës aktive dhe të shëndetshme;
- promovimi i turizmit malor;
- mbrojtja dhe promovimi i natyrës.

Neni 3 – Disiplinat

Gara zhvillohet në këto kategori:

- Trail 10 KM
- Trail 23 KM

Organizatori rezervon të drejtën të ndryshojë distancën, trasenë ose orarin e garës në rast të kushteve të pafavorshme atmosferike apo arsyeve të sigurisë.

Neni 4 – Kushtet e Pjesëmarrjes

- Çdo garues merr pjesë me përgjegjësi personale.
- Garuesit duhet të jenë në gjendje të mirë fizike dhe shëndetësore.
- Me regjistrim, pjesëmarrësi pranon këtë rregullore dhe rreziqet që lidhen me vrapimin malor.
- Pjesëmarrësit nën moshën 18 vjeç duhet të kenë leje nga prindi ose kujdestari.

Neni 5 – Regjistrimi

- Regjistrimi bëhet online përmes platformës zyrtare të garës.
- Numri i pjesëmarrësve është i kufizuar.
- Regjistrimi konsiderohet valid vetëm pas pagesës së kotizimit.
- Organizatori ka të drejtë të mbyllë regjistrimet para afatit nëse plotësohet numri maksimal i garuesve.

Neni 6 – Paketa e Garuesit

Çdo garues përfiton:

- Numër startues;
- Matje elektronike të kohës;
- Furnizime në checkpoint;
- Medalje “finisher” për ata që përfundojnë garën;
- Shërbim emergjent bazik gjatë aktivitetit.

Neni 7 – Pajisjet e Detyrueshme

Secili garues duhet të ketë gjatë gjithë garës:

- Telefon mobil me bateri funksionale;
- Sasi të mjaftueshme të ujit;
- Veshje sportive të përshtatshme për terren malor;
- Numrin startues të vendosur në pjesën e përparme dhe të dukshëm.

Organizatori mund të kërkojë pajisje shtesë varësisht kushteve atmosferike.

Neni 8 – Checkpoint dhe Furnizimi

- Garuesit duhet të kalojnë në të gjitha checkpoint-et zyrtare.
- Ndihma jashtë checkpoint-eve lejohet vetëm nëse nuk pengon garën apo pjesëmarrësit tjerë.
- Hedhja e mbeturinave jashtë zonave të lejuara ndalohet rreptësisht.

Neni 9 – Siguria

- Organizatori siguron ekipe vullnetarësh dhe asistencë emergjente bazike.
- Çdo garues ka obligim të ndihmojë një pjesëmarrës tjetër në rast emergjence.
- Organizatori mund të ndalojë vazhdimin e garës për një pjesëmarrës nëse konsiderohet rrezik për shëndetin apo sigurinë e tij.

Neni 10 – Diskualifikimi

Garuesi mund të diskualifikohet nëse:

- Shkurton trasenë;
- Nuk respekton udhëzimet e organizatorit;
- Nuk kalon në checkpoint-et e përcaktuara;
- Hedh mbeturina në natyrë;
- Ka sjellje jo sportive ndaj pjesëmarrësve apo stafit;
- Përdor mjete transporti gjatë garës.

Neni 11 – Limiti Kohor

Organizatori cakton limit kohor për secilën distancë. Garuesit që nuk arrijnë checkpoint-et brenda limitit mund të ndalohen nga vazhdimi i garës për arsye sigurie.

Neni 12 – Rezultatet dhe Ankesat

- Rezultatet publikohen pas përfundimit të garës.
- Çdo ankesë duhet të dorëzohet brenda afatit të përcaktuar nga organizatori.
- Vendimi final i organizatorit është përfundimtar.

Neni 13 – Përgjegjësia

Organizatori nuk mban përgjegjësi për:

- Lëndime personale;
- Humbje apo dëmtim të pajisjeve personale;
- Probleme që vijnë si pasojë e mosrespektimit të kësaj rregulloreje.

Neni 14 – Mbrojtja e Natyrës

Trail running zhvillohet në ambient natyror. Çdo pjesëmarrës ka obligim të:

- Ruajë natyrën;
- Mos dëmtojë florën dhe faunën;
- Mos lërë mbeturina në trase.

Neni 15 – Përdorimi i Fotografive dhe Videove

Me pjesëmarrje në garë, garuesi pranon që fotografitë dhe videot e realizuara gjatë aktivitetit mund të përdoren nga organizatori për promovim pa kompensim shtesë.

Neni 16 – Verifikimi i Rezultateve

- Organizatori ka të drejtë të kërkojë nga garuesit që përfundojnë në podium ose nga garues të tjerë të përzgjedhur, regjistrimin GPS të aktivitetit nga pajisje sportive apo aplikacione si Strava, Garmin Connect apo platforma të ngjashme.

- Garuesi duhet të jetë në gjendje të dëshmojë se e ka ndjekur trasenë zyrtare të garës.
 - Në rast të mungesës së dëshmive ose mospërputhjes së konsiderueshme me trasenë zyrtare, organizatori rezervon të drejtën për verifikim shtesë apo diskualifikim.
 - Organizatori mund të përdorë të dhënat nga checkpoint-et, fotografitë, videot dhe regjistrimet GPS për konfirmimin e rezultateve.
-